



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Bajram Mulaku Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Shpëtim Zhegrova Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Murtezani, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 08/03/2017
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	020-395
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 48/17 për dhënien në diskutim publik për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 139/11 e datës 30.06.2011 për Shërbimet e Transportit me " Merimangë në Territorin e Komunës së Vushtrrisë.
I miratuar më datë më datë: 23.02.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.03.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Bajram Mulaku, gradonačelnik opštine Vučitrn Shpetim Zhegrova, predsedavajući Skupštine opštine Vučitrn	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Dana: 08.03.2017. 020-395
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Vučitrn	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.48/17 za stavljanje na javnu diskusiju izmenu i dopunu Uredbe, br. 139/11 dana 30.06.2011. godine, o uslugama prevoza šlep službe na teritoriji opštine Vučitrn.
Usvojena dana: 23.02.2017.
Dostavljen MALS-u na razmatranje dana: 06.03.2017.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVES	
KOMUNA E VUSHTRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br.	48 / 17
Nr. i fq. / Br. si	- / -
Data / Datum	23.02.2017
VUSHTRRI - VUCITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.139/11 për Shërbimet e Transportit me "Merimangë" në Territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë nëpër Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

VENDIM PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

- Jepet në diskutim publik Draft-Rregulorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.139/11 e datës 30.06.2011, për Shërbimet e Transportit me "Merimangë" në Territorin e Komunës së Vushtrrisë.
- Diskutimi publik fillon nga data 27 shkurt 2017 dhe zgjat deri më 17 mars 2017.
- Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
- Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike (DSHP-ja) që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin mars 2017.
- Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit

HYRESE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
DEVEHA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data	06.03.2017		
Datum			
Date			
Mjesta organizative/	Nr. i Lënoit	Strojica	Vlera
-5-	000-331		